

V E N D I M
Nr.33, datë 23.7.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Manol Konomi,	Anëtari	“““
Veli Budo,	Anëtari	“““
Alfred Karamuço,	Anëtari	“““
Hilmi Dakli,	Anëtari	“““
Franc Jakova,	Anëtari	“““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 18.7.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr.37 Akti, që i përket :

K Ë R K U E S : KESHILLI I RRETHIT KUKES, i përfaqësuar nga Z. Ukë Todaj.

SUBJEKT I INTERESUAR: SEKRETARIATI SHTETEROR I PUSHTETIT LOKAL, në mungesë.

O B J E K T I :

Deklarimi antikushtetues i Vendimit nr.449, datë 24.6.1996 të Këshillit të Ministrave për shpërndarjen e Këshillit të Rrethit Kukës, të nxjerrë në bazë të paragrafit të fundit të nenit 1 të Ligjit nr.8068, datë 15.2.1996 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.7572, datë 10.6.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Duke marrë parasysh se në bazë të nenit 12 paragrafi i dytë të Ligjit nr.7570, datë 3.6.1992 “Për disa shtesa në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, shpërndarja e organeve të zgjedhura të pushtetit lokal bëhet me dekret të motivuar të Presidentit të Republikës;

Duke marrë parasysh se Ligji nr.8068, datë 15.2.1996, neni 1 paragrafi i fundit, shpërndarjen e këshillit të rrethit, kur nuk arrin të zgjedhë kryetarin e ri, e ka kaluar në kompetencën e Këshillit të Ministrave, gjë që vjen në kundërshtim të hapur me përmbajtjen e një dispozite kushtetuese, me normën e nenit 12 paragrafi i dytë të Ligjit nr.7570, datë 3.6.1992;

Duke marrë parasysh se Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.449, datë 24.6.1996 për shpërndarjen e këshillit të rrethit Kukës mbështetet në një dispozitë ligjore (neni 1 paragrafi i fundit i Ligjit nr.8068, datë 15.2.1996) që vjen në kundërshtim me kushtetutën;

Duke marrë parasysh se Gjykata Kushtetuese ka të drejtën të marrë në shqyrtim motu proprio dhe të vendosë mbi pajtueshmërinë me kushtetutën e një ligji ose i një

dispozite të veçantë të ligjit;

Duke marrë parasysh se nuk doli që këshilli i rrethit Kukës të jetë vetëshpërndarë;

Në mbështetje të neneve 24 (pikat 2 e 3) dhe 26 të Ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, njëzëri,

V E N D O S I :

1. Shfuqizimin si antikushtetues të fjalisë së fundit të paragrafit të katërt të nenit 1 të Ligjit nr.8068, datë 15.2.1996 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.7572, datë 10.6.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, me këtë përmbajtje: “Në rast se Këshilli i Rrethit nuk arrin të zgjedhë kryetarin e tij, Këshilli i Ministrave

shpërndan këshillin dhe cakton një të deleguar të tij për funksionimin e administratës, sipas dispozitave të këtij ligji”.

2. Shfuqizimin si antikushtetues të Vendimit nr.449, datë 24.6.1996 të Këshillit të Ministrave.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi për pikën 1, të nesërmen e

botimit të tij në Fletoren Zyrtare, ndërsa për pikën 2, nga data e shpalljes.
U shpall sot, më 23.7.1996